



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. _____/2023

PËR

**DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8402, DATË
10.9.1998, “PËR KONTROLLIN DHE DISIPLINIMIN E PUNIMEVE TË
NDËRTIMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, **81, pika 1** dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

Neni 1

Neni 2, zëvendësohet si më poshtë:

*“Ky ligj zbatohet për të gjitha **projektimet**, punimet e zbatimit, mbikëqyrjet dhe kolaudimet e punimeve të ndërtimit, që realizohen nga persona fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas projekteve të miratuara nga autoritetet përgjegjëse të zhvillimit të territorit.”*

Neni 2

Në Nenin 7/1 “Përgjegjësia e mbikëqyrësit”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- në pikën “1”, pas fjalëve “*Inspektoriatin Vendor të Mbrojtjes së Territorit të bashkisë*”, shtohet togfjalëshi “*dhe Sekretariatin teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit (KKTU) për lejet e ndërtimit të lëshuara nga KKTU*”.
- në pikën “2”, togfjalëshi “*autoritetin përgjegjës së planifikimit*” ndryshohet me togfjalëshin “*autoritetin përgjegjës së zhvillimit*”

Neni 3

Në Nenin 8, pika “6”, pas togfjalëshit “*Inspektoriatin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit*”, shtohet togfjalëshi “*dhe Sekretariatin teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit për lejet e ndërtimit të lëshuara nga KKTU*”.

Neni 4

Në Nenin 9, paragrafi i parë zëvendësohet si më poshtë:

“Për të gjitha objektet e përkufizuara në pikën “1” të nenit 3 të këtij ligji, zbatuesi i punimeve, përpara fillimit të punimeve, duhet të njoftojë në seksionin e urbanistikës dhe Inspektoriatin Vendor të Mbrojtjes së Territorit të bashkisë, si dhe Inspektoriatin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe Sekretariatin Teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, për lejet e ndërtimit të lëshuara nga KKTU.”

Neni 5

Pas Nenit 10, shtohet Neni 10/1, si më poshtë vijon:

“NENI 10/1

“Sekretariati Teknik i KKTU kryen monitorimin e procesit të punimeve të ndërtimit, kryesisht, apo në rast se vihet në dijeni nga qytetarët, nga subjektet e përcaktuara në këtë ligj, ose nga inspektoriatet sipas legjislacionit për

inspektimet, për shkelje të lejeve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, pasi të ketë vlerësuar situatën rast pas rasti, në varësi të kompleksitetit që mund të paraqesë projekti i miratuar nga KKTU.

Neni 6

Në Nenin 13 bëhen këto ndryshime:

- në paragrafin e parë togfjalëshi *“autoriteti vendor i zhvillimit të territorit”* zëvendësohet me togfjalëshin *“autoriteti përgjegjës i zhvillimit të territorit”*;
- paragrafi i katërt dhe paragrafi i pestë zëvendësohen me këtë përmbajtje:
“Agjencia Shtetërore e Kadastrës, kryen regjistrimin e objektit, në bazë të kërkesës së njësisë së qeverisjes vendore, apo Sekretariatit teknik të KKTU, sipas përgjegjësive në përputhje me legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, për pronarët e truallit dhe subjektet, me të cilat zhvilluesi ka pasur aktmarrëveshje ose kontratë sipërmarrjeje.”
“Njësia e qeverisjes vendore apo Sekretariati teknik i KKTU, sipas përgjegjësive në përputhje me legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, janë të detyruar që të depozitojnë pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës certifikatën e përdorimit brenda 60 ditëve nga lëshimi i saj.”

Neni 7

Në Nenin 14/3 *“Përgjegjësia e zhvilluesit”*, bëhen këto shtesa:

- në pikën *“2”*, pas fjalëve *“Inspektoriatin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit”*, shtohet togfjalëshi *“dhe Sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit (KKTU) për lejet e ndërtimit të lëshuara nga KKTU”*.
- në pikën *“3”*, pas fjalës *“Bashkitë”*, shtohet togfjalëshi *“dhe Sekretariati teknik i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit.”*

Neni 8

Kudo në tekstin e këtij ligji, emërtimet:

- *“inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut” zëvendësohen me “Inspektorati vendor i mbrojtjes së territorit të bashkisë”;*
- *“autoriteti përgjegjës i planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit” dhe “autoriteti përkatës i planifikimit” zëvendësohen me “autoriteti përgjegjës i zhvillimit të territorit”;*
- *“leja e përdorimit” zëvendësohen me “çertifikata e përdorimit”.*

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

LINDITA NIKOLLA